

PREPORTR



100 MILIONË

Mbi 100 milionë euro janë përfitimet e kompanive që kanë financuar dy fushatat elektorale të PDK-së.

Visar Duriqi dhe Qëndrim Bunjaku (2-4)

SA PËR SY E FAQE.

Së paku 25 zyrtarë të lartë publik nuk i kanë deklaruar të gjitha bizneset apo aktivitetet në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Besnik Boletini (4-6)

MERR-JEP.

Subjektet politike në Kosovë kanë marrë donacione për fushatë më shumë se sa u lejohet me ligj. Besa Kalaja (7-8)

PLUS

GRAFIKA DHE ILUSTRIME
MBI PËRMASAT E
KORRUPCIONIT NË KOSOVË.





MBI 100 MILIONË EURO JANË PËRFITIMET E KOMPANIVE QË KANË FINANCUAR DY FUSHATAT ELEKTORALE TË PDK-së.

Preportr ka marrë në shqyrtim afër 500 kontrata të ndryshme që janë lëshuar nga autoritetet publike ku nga këto ka nxjerrë të dhëna mbi kompanitë që kanë përfituar nga tenderët publik. Këto të dhëna janë krahasuar me të dhënat e nxjerra nga dy raportet e auditimit të KQZ-së, ku pasqyrohen subjektet fizike dhe juridike që kanë financuar partitë politike. Prej këtyre raporteve të KQZ-së, ka dalë që si subjekte juridike, 18 sosh i kanë financuar dy fushatat e fundit elektorale të PDK-së, ndërsa si subjekte fizike, (pronarët e kompanive të caktuara) janë 22 sosh. Nga shuma totale prej 100 milionësh që kanë përfituar financuesit e PDK-së, 80 milionë vijnë vetëm nga Ministria e Arsimit dhe ish-Ministria e Transportit tash Infrastrukturës.

100 MILIONË

VISAR DURIQI DHE QËNDRIM BUNJAKU

Ky hulumtim i "Preportr" mbi prokurimet publike nxjerrë thjesht dhe pa ndonjë koment të dhëna mbi 100 milionët e shpërndarë nga partia e kryeministrit, për kompanitë që atij ia zgjatën dorën gjatë fushatave zgjedhore. Nga dokumentet zyrtare ky hulumtim ka gjetur se 43 subjekte të ndryshme, kryesisht kompani ndërtimore që si biznese dhe persona fizik financuan Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), në dy fushatat e fundit elektorale kanë përfituar mbi 100 milionë euro nga tenderët publik. Sipas raportit të auditimit të financave të partive për fushatën e vitit 2009 dhe atij për fushatën e vitit 2010, shuma e donacioneve që këto 43 subjekte dhanë për PDK-në është pak më shumë se 280 mijë euro. Për 11 nga to u shkel edhe ligji dhe u dëmtua buxheti për t'i shpërblyer. Kjo i bie që kompanitë kanë rritur të ardhurat e tyre nga pushteti për mbi 350 herë në krahasim me atë që i dhanë donacion partisë në pushtet. Pasi "Preportr" ka gjetur këto të dhëna, ka pritur për më shumë se dy javë për një koment nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe nga Zyra e kryeministrit Hashim Thaçi, por as njëra dhe as tjetra nuk janë prononcuar në lidhje me shpër-

blimin prej 100 milionë eurosh të financuesve të kësaj partie me anë të tenderëve publik.

Por, kjo marrëdhënie në një pjesë të konsiderueshme zhvillohet larg mundësisë së monitorimit me dokumentacione, sepse thjesht një pjesë e konsiderueshme e financave të partive nuk është e mundur të identifikohen. Këtu flitet vetëm për kompanitë për të cilat ka mbështetje me dokumente zyrtare se janë të përfshira në financimin e partisë në pushtet, por duhet pasur parasysh se një numër i madh i tenderëve publik iu jepet kompanive që janë të afërta me PDK-në, por se nuk kanë ndonjë bashkëpronësi formale, apo nuk dalin as si financues të partive politike. "Al-Trade", pronë e Bajram Gashanit është një kompani shumë e pranishme në tenderët publik, pronari i se cilës është me origjinë nga qendër-peshimi i PDK-së, Drenasi. Kjo kompani, vetëm në Ministrinë e Arsimit ka marrë shtatë tenderë me vlerë prej afro 9 milionë euro. Kjo kompani në konzorcium me kompaninë "Ada Consulting Group", pronë e zyrtarit të Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK), Avni Kastrati, ka marrë një tender prej 600 mijë eurosh nga

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, sipas Auditorit Gjeneral ishin shkelur kërkesat e donatorit, Ambasada e Britanijeve për procedura të veçanta të prokurimit, Ministria e Kthimit ia ka vazhduar kontratën kësaj kompanie për projektin për ndërtimin e banesave për minoritetet.

PDK-ja ka shpërblyer edhe të afërmit e gazetarëve që mbajtën anën e kësaj partie. Kompania "Albes" nga Istogu, pronë e Hajredin Mavrajt ka marrë nga 5.7 milionë euro vetëm nga MASHT, kur atë e udhëhoqte ish-Ministri Enver Hoxhaj, tash Kryediplomat i Kosovës. Familjari i pronarit

të kësaj kompanie, Muhamet Mavraj, boton gazetën "Epoka e Re", që është e afërm me PDK-në.

Kjo kompani, pos tenderëve në MASHT, ka marrë tender milionësh edhe nga institucionet e tjera që udhëhiqen nga njërit e PDK-së, madje edhe duke ofertuar me çmime 1200 % më të shtrenjta se ato në treg. Në tenderin e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) "Ndërtimi i ndërtesës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë", përfaqësuesi i kompanisë "Albes", në seancën e mbajtur në OSHP në lidhje me problemet që dolën me këtë tender e pranon publikisht se qëllimisht ka përdorur çmime 1200 %

më të shtrenjta se në treg. Në po këtë seancë, përfaqësuesi i kësaj kompanie thotë se të njëjtën, sipas tij strategji, e ka aplikuar edhe në mbi 100 projekte tjera por megjithatë është shpërblyer me kontratë.

"Preportr" ka bërë kërkesë zyrtare në Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për të interpretuar ligjshmërinë e shpërblimit të "Albesit" me këtë "strategji", por ky institucion nuk ka pranuar ta interpretojë këtë çështje.

Afërsia me pushtet ka mundësiar edhe shfrytëzimin e institucioneve publike, siç është RTK-ja, për të shpërblyer njerëzit e vet. Shaip Muja,

KORPORATA "DEVOLLI" DHA 1 MJË EURO, MORI KONTRATËN PËR TELEFONINË MOBILE VIRTUALE NË KUADËR TË VALA 900, QË KA QARKULLIM MILIONËSH NË VIT DHE DY PRIVATIZIME DUKE QENË NËN HETIM, PËRKUNDËR RREGULLAVE TË AKP-së

| | | | | | | | |
|---------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| "AHN GROUP" dha 2 mijë euro, mori 447 mijë euro | "Ard Group" dha 2 mijë euro, mori 8.7 milionë euro | "Burimi" dha 4 mijë euro, mori 12 milionë e 227 mijë euro | "GRANITI" i dha 3300 euro, mori 555 mijë euro | "ITK" dha 986 euro, mori 1 e 5 e 94 mijë euro | "Jehona" dha 3500 euro, mori 1 milion e 676 mijë euro | "Magjistralla" dha 2500 euro, mori 2.7 milionë euro | "Mati - Com" dha 1 mijë euro, mori 312 mijë euro |
| "Ndërtimi" dha 3500 euro, mori 1 milion e 129 mijë euro | "Shkoza F07" dha 1 mijë euro, mori 834 mijë euro | "Stubla" dha 9700 euro, mori 3 milionë e 983 mijë e 684 euro | "Timi Krško" dha 1 mijë euro, mori 15.9 milionë e 75 mijë euro | "Alfa" dha 2500 euro, mori 530 mijë euro | "Beli" dha 500 euro, mori 130 mijë euro | "Arbëri-NS" dha 500 euro, mori 1 milion e 130 mijë euro | "Adessa" dha 3 mijë euro, mori 76 mijë euro |
| | | | | | "Riza A.M" dha 150 euro, mori 495 mijë euro | "MEB-NG" dha 500 euro, mori 126 mijë euro | |

SA FITUAN FINANCUESIT E PDK-SË SI BIZNESE?

SA FITUAN FINANCIUESIT E PDK-së SI PERSONA FIZIK?

| | | | | | |
|-------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|
| MORI 150.000 EURO | MORI 11.700.000 EURO | MORI 11.000.000 EURO | MORI 8.000.762 EURO | MORI 2.497.000 EURO | MORI 7.500.000 EURO |
| XHAFER ZHARKU "SHKËNDIA" DHA 650 EURO | VIKTOR DELIA "DELIA GROUP" DHA 500 EURO | ISMET KONUSHEVCI "BENI COM" DHA 3.900 EURO | FLORIM ZUKA "TALI" DHA 11.000 EURO | ABDURRAHIM KELMENDI "SOLID COMPANY" DHA 4.000 EURO | BASRI KÇIKU "BEJTA COMERC" DHA 1.499 EURO |
| MORI 138.000 EURO | MORI 400.000 EURO | MORI 110.000 EURO | MORI 2.378.000 EURO | MORI 1.800.000 EURO | MORI 113.000 EURO |
| SAFET SINANI "NDERTIMI" DHA 2.000 EURO | AFRIM SYLA "DONI COMERC" DHA 2.000 EURO | HYSNI SHABANI "HYSNIA" DHA 1.000 EURO | NAIM BESIMI "GETOARI" DHA 3.300 EURO | RESHAT KAMBERI "ENGINEERING" DHA 1.000 EURO | SELVIJE DEDA "EUROTRANS" DHA 1.000 EURO |
| MORI 1.289.000 EURO | MORI 40.000 EURO | MORI 10.000.000 EURO | MORI 766.000 EURO | MORI 725.000 EURO | MORI 1.116.000 EURO |
| BUJAR SHABANI "BAGERI" DHA 1.000 EURO | ILMI AZEMI "KORABI-COMPANY" DHA 800 EURO | MUSTAFË SHALA "COMPACT GROUP" DHA 5.500 EURO | KASTRIOT FAZLIA "KASTRIOTI" DHA 1.000 EURO | ELBASAN ALIDEMA "METALI" DHA 2.000 EURO | PETRIT JERLIU "TEUTA - M" DHA 2.000 EURO |
| MORI 231.000 EURO | MORI 53.000 EURO | MORI 126.000 EURO | MORI 123.000 EURO | | |
| HAJRUSH MISINI "HAJRUSHI" DHA 1.000 EURO | SHPEND MUSA "VISION PROJECT" DHA 2.000 EURO | MEHMET ISMAILI "MERMER COMMERC 1" DHA 1.000 EURO | MUSTAFË BAJRAKTARI "BAJRAKTARI" DHA 500 EURO | | |

ish-këshilltar i Kryeministrit Hashim Thaçi, që për PDK-në ka dhënë donacion 1 mijë euro ka 50% të aksioneve në "Ana Derm", kurse 50% të tjera i takojnë gruas së tij, Anita Muja. Ajo është edhe pronare në kompaninë tjetër private "Ana-Z", me anë të së cilës ka përfutuar një kontratë nga fondet publike të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), por që këta të fundit nuk pranojnë të bëjnë publike vlerën e saj.

Edhe vëllai i deputetit Muja, Fatmir Muja, nuk është lënë anash. Kompania "CI-KOS", pronë e Fatmir Mujës, e cila sipas të dhënave të Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve merret me riciklimin e mbeturinave dhe hedhurinave metalike kishte fituar tenderin për shitjen e mbetjeve të metalit nga kjo korporatë, derisa me prokurimin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) po udhëhiqte Njazi Thaçi, tash zëvendës-drejtor i kësaj korporate dhe njëherazi edhe kushëri i Kryeministrit Thaçi. Kjo kompani tash është në pronësi të Fatmir Mujës, vëllai i deputet Shqip Muja dhe numri kontaktues i kësaj kompanie është i njëjtë me kontaktin e kompanisë "Kosova Green Energy", biznes i deputetit Shqip Muja, i cili nuk është deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Tenderë me çdo kusht për donatorët e partisë

Financuesit e partisë së Kryeministrit Thaçi, tradicionalisht janë edhe kontraktorët të komunave që drejton kjo parti, por si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, për t'u dhënë kontratat publike atyre institucionet nuk ishin "kursyer" në shkeljen e ligjit.

"Preportr" gjeti se nga 43 financues të PDK-së, duke përfshirë këtu edhe ata që donacionet për parti-në në pushtet i dhanë si biznese, por edhe ata që i dhanë si persona fizik, por me kompanitë e tyre përfutuan kontrata publike, për 11 prej tyre, pa përfshirë këtu kontratën mes Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK dhe "Devolli Group", u shkel ligji për t'i shpërblyer ato. Shkeljet në këto raste janë konstatuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).

"Devolli Group", pronë e vëllezërve Blerim e Shkëlqim Devolli edhe pse zyrtarisht për PDK-në ka dhënë vetëm 1 mijë euro, dhe atë vetëm për degën e saj në Pejë, kjo korporatë u shpërblye me tenderin për operatorin virtual në kuadër të telefonisë mobile publike, Vala 900, të njohur në treg si "Z-Mobile". Kjo kontratë, nga e cila kompania "De-

vollit", realizon miliona euro qarkullim është nënshkruar, pos nga ish-Kryeshefi Ekzekutiv i PTK-së, Shyqeri Haxha edhe nga Kryetari i Bordit të kësaj korporate, Rexhë Gjonbalaj, ish-kryetar i degës së PDK-së në Pejë. Po për këtë kontratë, Prokuroria e EULEX-it, ka ngritur një aktakuzë për pesë vepra penale ku përfshihet krimi i organizuar, mashtrimi e falsifikimi me dokumente, e cila është konfirmuar nga gjyqtarë të këtij misioni dhe në bankën e të akuzuarve për këtë rast tash janë: Shyqeri Haxha, Rexhë Gjonbalaj, Blerim e Shkëlqim Devolli si dhe Ismet Bojku.

Duke qenë në procedura penale, përkundër rregullave të privatizimit, "Devolli Group" privatizoi dy ndërmarrje: "Amortizatorët" dhe "Emin Duraku"

Shkelje të rënda të ligjit janë gjetur nga ZAP për korporatën "Compact Group", nga Gjilani, pronë e Mustafë Shalës. Kjo kompani, pronari i së cilës është edhe ortak biznesi me kryetarin e Gjilanit, Qemaj Mustafa, në kompaninë për pjekjen e bananeve "Viva Fruta", është kontraktor i Komunës së Gjilanit në vazhdimësi. Përpos miliona eurosh para publike, që ka marrë nga Komuna e Gjilanit, kjo Komunë në vitin 2011

miraton edhe shkëmbimin e pronës në mes të Hotel "Kristalit" të Mustafë Shalës dhe Komunës së Gjilanit. Shala do t'i jap Komunës një pronë prej 479 metra katrorë, që sipas opozitës së kësaj Komune shumë më pak e vlefshme se sa një parcelë prej 433 metra katrorë para këtij hoteli dhe buzë rrugës kryesore të qytetit, të cilën korporata "Compact Group" përfitoi në ndërrim me Komunën.

Por, ligji për "Compact Group" u shkel në tenderët milionësh që përfitoi në "Termokos", në kohën kur kjo kompani drejtohej nga Fëllan-za Pula. Për dy sezona, 2009-2010, 2011-2012 "Compact Group" ishte kontraktuar nga "Termokos" për furnizim me mazut, shpenzimet e të cilit për një sezon sillen nga 5-7 milionë euro. Po për këtë kompani, "Termokos" kishte shkelur ligjin duke nënshkruar kontratë me të në kohën kur ajo nuk kishte licencë për furnizim me mazut dhe derivate të naftës si dhe duke paguar shumëfish më shtrenjtë se në kontratë mazutin. Për më shumë, në vitin 2010 kur "Compact Group" mori edhe një herë tenderin e mazutit procedura për zgjedhjen e kompanisë ishte anuluar dy herë.

Kur është fjala për financuesit, as komunat e PDK-së nuk e "kursyer" ligjin. Komuna e Ferizajt, që udhëhiqej nga Bajrush Xhemajli i PDK-së, për kompaninë "Bageri", që për pronar ka Bujar Shabanin nga Ferizaj, e që në vitin 2009 kishte dhënë 1 mijë euro donacion për PDK-në, sipas ZAP-it po në vitin 2009 bëri shkelje të ligjit mbi financat publike. Në projektin për asfaltimin e rrugës në fshatin Komogllavë, që i kushtoi komunës mbi 125 mijë euro, komuna e Ferizajt kishte paguar këste në vlerë më të madhe se sa që parashihet kontrata me "Bagerin", në favor të kompanisë dhe ZAP këtë gjetje e kishte futur tek shkeljet që i klasifikoi si "rrezik i lartë".

Kjo kompani, sipas profilin të saj në internet, si pjesë të saj ka edhe bazën e prodhimit të asfaltit në komunën e Lipjanit, emri i së cilës është "Kosova Asfalt". Kjo e fundit, në një publikim të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor është futur në listën e kompanive të cilat me veprimtarinë e tyre e dëmtojnë ambientin. Në këtë publikim, "Kosova Asfalt" e kompanisë "Bageri" thuhet se ndotë ujërat nëntokësore, por nuk përmendet se çfarë masash janë marrë ndaj saj.

Për kompaninë "Bajraktari", pronë e Mustafë Bajraktarit, që për PDK-në në vitin 2009 dha 500 euro që t'i jep tender me çdo kusht edhe duke shkelur ligjin, u "kujdes" kompania "Trepça". Në një kontratë në vitin 2010, për furnizim me derivate, "Trepça" kishte shkelur Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) disa herë. ZAP në kontratën, në vlerë prej 124,088€, ka gjetur se "Trepça" e nënshkroi kontratën duke shkelur afatet ligjore ani pse kompania kishte mungesë të dokumenteve dhe se mjetet që iu zotuan kësaj kontrate ishin bartur jashtë-ligjshëm për këtë punë nga linja e mallrave dhe shër-

bimeve. ZAP kishte konstatuar se për "Bajraktarin", "Trepça" shkeli edhe marrëveshjen për Monitorim dhe Kontroll. Me gjithë shkeljet e ligjit që u bënë për t'ia dhënë tenderin "Bajraktarit", kjo kompani e humbi këtë kontratë pasi që dështoi të furnizonte "Trepçën" dhe kontrata pastaj iu dha "HIB Petroli" në vlerë prej 254,760€, apo dyfish më e lartë.

Donatori i PDK-së ndihmohet nga USAID-i

Kompania "Bejta Comerc", në pronësi të Basri e Adem Kçikut, e që në dy fushatat zgjedhore më 2009 e 2010 dha për PDK-në 1499 euro është e rrethuar me shkelje e konflikte të interesit. Kjo kompani, që është mbështetur edhe nga programi i USAID-it në Kosovë me një kredi prej 900 mijë eurosh, kishte marrë një tender për asfaltimin e disa rrugëve të fshatrave në Komunën e Kamenicës, ani pse OSHP-ja kishte konstatuar se Kamenica shkeli ligjin kur ia dha këtë tender.

Po për këtë kompani shkeljet e ligjit vazhduan. Në korrik të vitit 2011 Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), që udhëhiqet nga ministri i PDK-së, Besim Beqaj, kishte ngritur dyshimin se kryetari i bordit të ndërmarrjes rajonale të Ujësllësit "Hidromorava" në Gjilan, Abdyl Hasani, ka konflikt të interesit. Ky konflikt ishte pikërisht për shkak të faktit që Hasani punonte edhe te "Bejta Comerc" si menaxher për Kualitete. Vetë Abdyl Hasani, që është i angazhuar nga komuna e Gjilanit edhe në Këshillin e Ekspertëve të kësaj komune, në një letër që ia kthen MZHE-së konstaton për vete se nuk ka konflikt të interesit, ani pse "Hidromorava" ka të kontraktuar për furnizim me fraksione të zhallit kompaninë "Bejta Commerce".

Për shkeljet që ishin bërë për ta shpërblyer kompaninë "Beni Com", pronë e Ismet Konushevcit e që është financues "kronik" i PDK-së, "Preportr" kishte publikuar edhe më herët hulumtime. Në hulumtimin me titull "Biznesi i partisë në pushtet", me të cilën "Preportr" u shpërblye me çmimin teksti më i mirë në media online për vitin 2011, bëhet me dije se kjo kompani ishte shpallur jashtë-ligjshëm fituese e tenderit mbi 3 milionësh të Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e rrugës Kuqishtë - Bogë, por që u anulua nga OSHP-ja.

Por ky vit, nuk i ka nisur mbarë "Beni Com-it". Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e kishte shpërblyer këtë kompani, në konzorcium me kompaninë "Ndërtimtari" në tenderin për shërbimet e largimit të djerinës, vlera e të cilit ishte 165 mijë euro. KEK, sipas OSHP-së, kishte bërë disa shkelje të LPP-së dhe tenderi shkoi në ri-vlerësim.

Për kompaninë N.N.P. "Engineering" me pronar Reshat Kamberi, e që për PDK-në në vitin 2009 dha 1 mijë euro, ligjin e kishte shkelur komuna e Ferizajt, që udhëhiqej deri tani nga njeriu i PDK-së, Bajrush Xhemajli. Ajo kishte derdhur në xhi-

► VAZHDON NGA FAQJA 3

rollogarinë e kompanisë më shumë para sesa që lejonte marrëveshja e kështu në projektin për renovimin e Teatrit të Qytetit, projekt ky që komunës i kushtoi afro 80 mijë euro. Në po këtë projekt, punët nuk janë pranuar nga gjysma e ekipit mbikëqyrës të punimeve. ZAP këto shkelje i ka klasifikuar të shkeljet me rrezikshmëri të lartë.

Disa institucione shkelin ligjin për një financues

Edhe komunat e vogla kishin shkelur ligjin për t'i shpërblyer financuesit e PDK-së. Për "Getoarin", në tenderin për ndertimin e rrugës së Xërxës, në vitin 2010, komuna e Dragashit pati bërë një sërë shkeljesh, por OSHP-ja e anuloi vendimin e kësaj komune që ta shpërblejë "Getoarin", kompani kjo pronë e Naim Besimit, i cili kishte dhënë për PDK-në në të dy fushatat 2300 euro, donacion që iu shpërblye nga MTPT-ja me tre tenderë dhe nga MASHT me një të tillë, e që vlera përbashkët e tyre arrin në mbi 4.1 milionë euro.

Po ashtu dy komuna me territor jo të madh, Komuna e Kamenicës dhe ajo e Novobërdës, dhe Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) kishin shkelur ligjin në favor të kompanisë N.T.P "Metali", pronar Elbasan Alidema nga Poshorani i Vitisë e që për PDK-në në të dy fushatat e fundit ka dhënë 2 mijë euro donacion.

ZAP-i gjeti se Kamenica kishte ndarë një projekt në disa shpenzime më të vogla se 10 mijë euro dhe ka bërë kontrata të veçanta dhe pagesa kompanisë "Metali" gjatë vitit 2008 duke ekzekutuar katër pagesa të veçanta me një total prej 18,286 eurosh, të cilat nuk i kishte botuar në gazetë si tenderë, siç kërkohej me Ligjin për Prokurimin Publik në fuqi atëherë. Sipas ZAP këtu është bërë favorizimi i kësaj kompanie. Një vit më vonë, në vitin 2009, sipas ZAP komuna e Novobërdës kishte shkelur dy herë LPP-në për "Metalin" në tenderin me furnizimin me material ngrohës: dru dhe thëngjill.

Në vitin 2010, KMDK kishte bërë shkelje të vazhdueshme në tenderin për furnizim me makineri të rëndë, ku shpallje fitues "Metali", por ankohej financuesi tjetër i PDK-së, "Getoari" nga Prizreni. Për këtë tender, vlera e të cilit ishte afro 400 mijë euro, ishin zhvilluar disa seanca në OSHP dhe ishte raportuar edhe në media.

Kompania "Shkoza FO7", biznes në pronësi të Fidaie Bytyçit, që në vitin 2009 për PDK-në dha 1 mijë euro e nga MTPT-ja ka marrë 2 tenderë në vlerë prej mbi 800 mijë eurosh, nga pasardhësja e MTPT-së, Ministria e Infrastrukturës. Në vitin 2011 në konzorcium me kompaninë "Ndërtimi", të dyja financues të PDK-së, ishin shpallur fitues të tenderit "Sanimi i rrugës Regjionale R105, segmenti: Klinë-Brojë, L=4.0km". Për këtë tender, "Preportr" por edhe media tjera kishin raportuar disa herë që është shoqëruar me shkelje, por ky

vendim, për shpalljen fitues të "Shkoza FO7 & Ndërtimi", u anulua nga OSHP-ja.

Në vitin 2011 për "Shkoza FO7" u kujdes komuna e Vushtrrisë, që udhëhiqet nga Bajram Maloku i PDK-së, e cila e angazhoi këtë kompani për mirëmbajtjen e rrugëve në dimër. Kjo informatë është dhënë nga Shtabi për Gatishmëri Emergjente i Vushtrrisë, por nuk është publikuar vlera e kontratës mes komunës dhe kompanisë.

Buja, biznes me financuesin dhe kontraktorin

Kryetari i Lipjanit, Shukri Buja, njëherit edhe kryetar i degës së PDK-së në Lipjan, nuk është mjaftuar vetëm me dhënien e tenderëve për kompaninë "Stublla", pronë e Avni Stubllës, nga fshati Topliçan i kësaj komune, e që në vitin 2010 për PDK-në dha 9700 euro e mori nga MASHT e komuna e Lipjanit afro 4 milionë euro. Buja pos që "Stubllën" e shpalli fitues në tenderin për të ndërtuar me koncesion objektin për familjet e dëshmorëve, veteranëve të luftës, familjet e martirëve dhe fëmijët bonjakë, kishte bërë edhe biznes privat me të. Sipas deklaramit të pasurisë së Bujës, ky i fundit kishte deponuar grurin në mullirin e këtij kontraktori të Qeverisë e Komunës që ai udhëheq derisa Hasan Preteni, Drejtor i AKK-së kishte thënë për "Zërin" se do të merret me këtë rast.

Ligjin mbi financat publike e kishte shkelur edhe komuna e Vitisë për kompaninë "Hajrush", pronari i së cilës, Hajrush Misini, për PDK-në dha 1 mijë euro donacion. Në tenderin prej 58 mijë eurosh nga komuna e Vitisë për ndërtimin e kanalit të hapur dhe rrugëve në rrugën 'Kongresi i Manastirit', sipas ZAP komuna derdhi në xhirrologarinë e 'Hajrushit' para më shumë se sa që lejoheshin sipas ratave që qenë përcaktuar në kontratë. "Ekziston rreziku që mjetet e Komunës janë keqpërdorur gjatë këtij procesi", thuhet në raportin e ZAP për Vitinë në vitin 2010, që këtë gjetje e kualifikojnë si rrezik i lartë.

Financuesit e PDK-së nuk ju ndanë as tenderëve një burimor, të kritikuar si tenderë me rrezikshmëri për favorizim nga ana e Komisionit Evropian. Bejtush Zhugolli, që për degën e PDK-së në Pejë në vitin 2009 dha 900 euro, ka në pronësi kompaninë "Pejton". Vëllezërit e tij, me firmat e tyre kanë qenë pjesë e tenderëve publikë në këto tri vitet e fundit, 2008-2009-2010 vlera e të cilëve shkon në mbi 70 milionë euro. Korporata Energjetike dhe Operatori i Sistemit e Transmisionit të Energjisë Elektrike KOSTT kanë shpallur fitues kompaninë "Eco Trade", pronë e Mehdi Zhugollit dhe atë "ACDC-KOS" të Ilmi Zhugollit në rreth dhjetë tenderë publikë, të cilët kanë pasur të bënë me ndërrime të stabilimenteve, furnizime me pajisje e tenderë për riparim të shiritave transportues. Këto kontrata kapin shumën rreth 70 milionë euro dhe pjesa më e madhe e këtyre tenderëve kanë qenë tenderë një burimor.

SA PËR SYE FAQE

BESNIK BOLETINI

Së paku 25 zyrtarë të lartë publik ndër të cilët një zv-kryeministër, dy ministra, katër zv-ministra, pesë kryetarë të komunave, një sekretar i përgjithshëm, katër drejtorë të prokurimit si dhe tetë anëtarë/drejtorë të bordeve të kompanive publike nuk i kanë deklaruar të gjitha bizneset apo aktivitetet në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Këta zyrtarë që nuk e kanë deklaruar një pjesë të pasurisë nuk janë hetuar fare nga AKK dhe nuk figurojnë në raportin vjetor të vitit 2011, i cili është bërë publik me 28 mars të këtij viti.




Së paku 25 zyrtarë të lartë publik, ndër ta ministra, zëvendësministra, kryetarë të komunave, drejtorë të prokurimeve si dhe drejtorë dhe anëtarë të bordeve të kompanive publike nuk e kanë deklaruar një pjesë të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Për më tepër ky fakt nuk ka gjetur vend as në Raportin Vjetor të AKK-së.

Gjetja e këtyre bizneseve të padeklaruara është bërë përmes krahasimit të formularit për deklaramin e pasurisë të AKK-së, të cilin e kanë plotësuar zyrtarët e lartë (të cilin e kanë pranuar zyrtarët e AKK-së) dhe databazës së ARBK-së, ku bizneset e këtyre zyrtarëve janë gjetur përmes numrit personal të letërnjoftimit. Bizneset e gjetura në ARBK në të cilat këta zyrtarë janë pronarë apo persona të autorizuar nuk figurojnë në formularin e deklaramit të pasurisë, që do të thotë se këto biznese nuk janë deklaruar fare.

Preportr po ashtu nga burime në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) ka gjetur që nga 25 biznese të zyrtarëve të lartë publik që nuk e kanë deklaruar një pjesë të pasurisë, 5 prej tyre kanë pasur qarkullim financiar ndër vite, përderisa 20 nga ta, të paktën zyrtarisht, nuk kanë pasur qarkullime financiare të deklaruara në ATK.

Sidoqoftë, me këtë veprim këta zyrtarë të lartë publik kanë shkelur Ligjin për Deklaramin e Pasurisë duke shkakuar kundërvajtje. Ligji për Deklaramin e Pasurisë i miratuar në vitin 2010 në nenin 4 – pika 3 thotë se: "Deklaramin në lidhje me gjendjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe familjarët e tyre, përmban informacione rreth pasurisë dhe të të ardhurave të tyre, siç është: zotërimi nga ana e tyre i aksioneve në shoqëri komerciale; Këtë obligim të deklaramit e precizon edhe më qartë Ligji i për Deklaramin e Pasurisë i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2011. Në Kreun e IV - neni 13, të këtij ligji mes të tjerave, thuhet se "personi publik duhet të deklarojë edhe funksionet apo aktivitetet tjera që i ushtron zyrtari krahas funksionit publik". Këtë përgjigje e ka dhënë edhe drejtori i AKK-së Hasan Preteni. Kur ai është pyetur se a duhet që zyrtarët e lartë publik të deklarojnë edhe bizneset nëse nuk kanë qarkullime financiare dhe në të cilat mund të jenë pronarë apo persona të autorizuar, ka thënë se "Zyrtarët e lartë publik në pajtim me nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-050,



LISTA ME BIZNESE TË PADEKLARUARA

- 1 Behgjet Pacolli, Zv. Kryeministër**
Tempore (NB: 70508745)
- 2 Radoica Tomić, Ministër për Kom. dhe kthim**
STR Fan (NB: 70081961)
- 3 Agim Çeku, Ministër i MFSK-së**
ATM Group (NB: 70656272)
- 4 Nexhmedin Kastrati, Zv. Ministër në MAP**
Qendra e Marketingut (NB: 70058118)
- 5 Cunejd Ustaibo, Zv. Ministër në MTI**
A.G.O.-AL - Dega në Kosove (NB: 70673991)
- 6 Hajdin Abazi, Zv. Ministër në MKRS**
Conn - Con (NB: 70664860)
- 7 Rifat Krasniç, Zv. Ministër në MAPL**
Mutlu (NB: 80485034)
- 8 Ilir Tolaj, Ish-sekretar perma. në MSH**
IMC (NB: 70050519)
- 9 Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekës**
Univerzal Group (NB: 70480619)
- 10 Nenad Cvtkovic, Kryetar i Komunës së Parteshit**
Mlp-Com (NB: 70348388), M&L-Com (NB: 70173874)
- 11 Shukri Buja, Kryetar i Komunës së Lipjanit**
Bulevardi (NB: 70158321)
- 12 Qemajl Mustafa, Kryetar i Komunës së Gjilanit**
Vision Oil (NB: 70352038)
- 13 Avni Kastrati**
Oil Trade (NB: 70150847), Eko-Kosova (NB: 70427328), Amar (NB: 70276279)
- 14 Afrim Maxhuni, Drejtor i prokurimit në MSFK**
AA-HD (NB: 70482717)
- 15 Feti Ibishi, Drejtor i prokurimit në MPMS**
Koperativa Bujqësore Malsia (NB: 70282175)
- 16 Adem Krasniqi, Drejtor i prokurimit në MTI**
Rrjeta (NB: 70028120)
- 17 Arben Loshi, Drejtor i prokurimit në MPJ**
Beni Keramikë (NB: 80427875)
- 18 Gani Sylaj, Anëtar i Bordit në PTK**
Dreni (NB: 70424955)
- 19 Nuhi Ahmeti, Anëtar i Bordit në PTK**
Natyra (NB: 80076436)
- 20 Fadil Ismaili, Drejtor në KOSST**
Arting (NB: 70600560)
- 21 Flamur Keqa, Anëtar i Bordit në KEK**
IBF consulting training (NB: 70494558)
- 22 Asllan Vitaku, Kryesues i Bordit në KMDK**
Asllan & Sons (NB: 80306989)
- 23 Hanefi Muharremi, Anëtar i Bordit në ANP**
Zyra e Shërbimeve Eksperti Muharremi (NB: 70509717)
- 24 Aleksander Janicevic, Ish-anëtar i Bordit në RTK**
Inter Commerce (NB: 70204548)
- 25 Rrahman Paçarizi, sh-kryetar i Bordit në RTK**
Instituti për Cilësi ARAC (NB: 70448807)

kanë për obligim të deklarojnë në formularin për deklarim të pasurisë të gjitha funksionet ose aktivitetet tjera krahas funksionit të lartë publik.

Ky obligim ligjor vlen për të gjithë zyrtarët publik derisa të ç'regjistrojnë bizneset apo të shpallin funksionin në bizneset përkatëse, e kjo duhet të bëhet në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK). Përfaqësuesit e ARBK-së thonë se një biznes shuhet kur ai fshihet nga Regjistri i Biznesit dhe mbyll obligimet tatimore.

Një ty, një mua...

Agjencia Kundër Korrupsionit e ka një konflikt të thellë me vetë rolin e tij. Ai duhet të kontrollojë zyrtarët nga të cilët drejtori i saj në vazhdimësi kërkon rritje të rrogave. Duket se kjo është arsyeja themelore pse AKK nuk dënon shkelësit e ligjit, por i mbron ata. Disi kjo marrëdhënie është bërë si njëra dorë që kruan tjetrën, apo një ty, një mua.


Bizneset e gjetura në ARBK në të cilat këta zyrtarë janë pronarë apo persona të autorizuar nuk figurojnë në formularin e deklarimit të pasurisë, që do të thotë se këto biznese nuk janë deklaruar fare. Drejtori i AKK-së, Hasan Preteni, gjatë prezantimit të Raportit vjetor për vitin 2011 nuk i ka përmendur fare zyrtarët e lartpërmendur, për më tepër ai ka thënë se "nuk ka zyrtarë qeveritarë të nivelit të lartë për të cilët ka nisur ndonjë procedurë hetimore për shkak të mosdeklarimit të pasurisë".

Kur në të kaluarën janë gjetur biznese të padeklaruara brenda afatit të rregullt ligjor, AKK nuk i ka dërguar ato në Gjykatën për Kundërvajtje, por i kontakton zyrtarët që nuk i kanë deklaruar bizneset dhe ua mundëson atyre që t'i deklarojnë, duke ua shtuar këto biznese apo funksione në regjistrin për deklarimin e pasurisë edhe pas afatit të paraparë ligjor.

Zyrtarët e AKK-së, jozyrtarisht kanë deklaruar se nëse nuk bëhet deklarimi i plotë nuk mund të merren masa ndëshkuese, sepse, sipas tyre, "Ligji për Deklarimin e Pasurisë nuk e parasheh një gjë të tillë dhe se ligji në fjalë krijon hapësira në këtë aspekt dhe nuk sanksionon deklarimin e pjesshëm". Ky fakt vërtetohet edhe në raportin e punës së vitit 2011 të AKK-së, pasi që 10 deputetët e Kuvendit të Kosovës që nuk i kanë deklaruar bizneset e tyre dhe pasi që Çohu dhe Preportri i ka dërguar në AKK, kjo e fundit vetëm i ka kontaktuar këta deputetë dhe tetë muaj pas afatit lig-

QARKULLIMET FINANCIARE TË 6 BIZNESEVE NGA GJITHSEJ 28


Behgjet Pacolli
ZËVENDËSKRYEMINISTËR, "TEMPORE"



Asllan Vitaku
VITAKU KRYESUES I BORDIT NË KDMK, "ASLLAN & SONS"



Rifat Krasniç
ZV. MINISTËR NË MAPL, "MUTLU"



Avni Kastrati
KRYETAR I KOMUNËS SË MITROVICËS, "OIL TRADE"



Nenad Cvtkovic
T.P. M&L-COM, G.T.P. MLP-COM



zor për deklarim, Agjencioni ua ka shtuar atyre bizneset që nuk i kanë deklaruar në formularët e deklarimit. Ata, pra, kanë pasur obligim t'i deklarojnë, por i kanë fshehur dhe AKK duke e konsideruar këtë si deklarim sipas kërkesës nuk i ka çuar në Gjykatën për Kundërvajtje, përveç njërit që nuk i është përgjigjur shpresës së AKK-së për të dhënë informata shtesë. Kjo do të thotë se një zyrtar i lartë publik mund t'i fshehë bizneset e tij dhe deklarimin e tyre ka mundësi ta bëjë vetëm nëse i zbulohen bizneset dhe për këtë mosdeklarim, sipas AKK-së, nuk merret asnjë masë ndëshkuese ndaj tij.

E kam ditur, se kam ditur

Preportri, ka kontaktuar me të gjithë zyrtarët e lartpërmendur (përveç Ilir Tolajt, i cili gjendet në paraburgim), dhe i ka pyetur për mos-deklarimin e kompanive përkatëse. Një pjesë e madhe e tyre thonë se këto biznese nuk janë aktive dhe se kanë menduar se nuk duhet që t'i deklarojnë, pasi që pre-

tendojnë se nuk kanë qarkullime financiare. Por Ligji për Deklarimin e Pasurisë i obligon këta zyrtarë që të deklarojnë çdo aktivitet biznesor, pavarësisht faktit se a janë këto biznese profitabile apo jo-profitabile, konkretisht edhe nëse bilanci i qarkullimit të tyre është zero, apo edhe negativ. Ky obligim praktikisht lidhet me faktin se edhe nëse sot bizneset e zyrtarëve në fjalë nuk kanë qarkullime financiare ato nesër mund të fillojnë aktivitetin pasi që janë të regjistruara në ARBK, pra janë aktive.

Zëvendëskryeministri i Kosovës Behgjet Pacolli nuk e ka deklaruar kompaninë "Tempore", në të cilën është pronar, ndërsa person i autorizuar është Rrustem Pacolli. Pacolli ka thënë se nuk e ka deklaruar këtë kompani në vitin 2011 për shkak se, sipas tij, ajo nuk ka veprimtari biznesore. "Kompania "Tempore" është pasive, është në procedurë të shuarjes dhe është në menaxhim të Rrustem Pacollit. Për gjithçka është e informuar AKK", ka thënë Pacolli. Por të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës tregojnë se Kompania e Pacollit ka pasur qarkullim dhe nuk është vlera e saj zero. Kompania "Tempore" në të cilën Pacolli është pronar, në vitin 2002 ka pasur 9 mijë e 290 euro qarkullim financiar, në vitin 2003 ka pasur 10 mijë e 612 euro dhe në vitin 2004 ka pasur 133 mijë e 450 euro.

Ministri për Komunitete dhe Kthim Radoica Tomić nuk e ka deklaruar fare kompaninë "STR Fan" në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Ministri Tomić përmes zyrës për informim ka deklaruar se nuk ka asnjë qarkullim financiar në këtë kompani dhe se kjo kompani për më shumë se 8 vjet është pasive, ndërsa ka deklaruar se do ta shuajë këtë biznes në ARBK. "....në xhirollogarinë e kësaj kompanie nuk ka të ardhura, gjë e cila mund edhe të verifikohet. Kjo kompani është regjistruar në emër të ministrit Tomić, ndërsa është udhëhequr nga motra e tij. Gjatë ditëve në vijim do të iniciojë procedurat për marrjen e dokumentacionit përcjellës nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për mos funksionimin e kompanisë në fjalë", thuhet në përgjigjen që ministri ka dhënë përmes zyrës për informim.

Ministri i Forcës së Sigurisë Agim Çeku nuk e ka deklaruar në AKK kompaninë "ATM Group" Sh.p.k., në të cilën është bashkëpronar me Tomislav Kaçiç-Alesiq dhe Mark Shalaj. Ministri Çeku thotë se këtë kompani nuk e ka deklaruar

► VAZHDON NGA FAQJA 5

ar, sepse sipas tij, ajo nuk ka funksionuar asnjëherë dhe nuk ka pasur asnjë qarkullim financiar. Ai thotë se duke e marrë parasysh këtë, ka menduar që ajo vetvetiu është shuar dhe nuk është e regjistruar në ARBK. “Ka qenë thjesht një përpjekje dhe ide e një shokut tim kroat kur atëherë kam qenë pa punë. Pasi që më keni kontaktuar dhe ju falënderoj që ma keni qit ndërmend menjëherë i kam marr masat për t’u hequr nga aty”, thotë Çeku.

Zëvendësministri në Ministrinë e Administratës Publike, Nexhmedin Kastrati, nuk e ka deklaruar kompaninë “Qendra e Marketingut”. Cyneyd Usaibo, zëvendësministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, nuk e ka deklaruar në AKK kompaninë “A.G.O.-AL.” - Dega në Kosovë, në të cilën është person i autorizuar. Hajdin Abazi, zëvendësministër në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nuk e ka deklaruar kompaninë “Conn - Con”, në të cilën është bashkëpronar me Ismet Bajramin. Të tre këta zëvendësministra tentojnë të japin arsyetimet të njëjta, duke thënë se bizneset e tyre nuk kanë aktivitete biznesore. Ata thonë se kanë menduar se pasi që nuk kanë qarkullime financiare nuk duhet që t’i deklarojnë.

Ndërsa, Rifat Krasniç, zëvendësministër në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, nuk e ka deklaruar kompaninë “Mutlu”. Krasniç është dënuar më datën 31.12.2011 nga gjykata komunale për kundërvajtje në Prishtinë për shkak se nuk e ka deklaruar fare pasurinë në AKK. Ai e ka deklaruar pasurinë më datën 01.11.2011, por nuk e ka deklaruar fare kompaninë “Mutlu”. Ai thotë se ka harruar që ta deklarojë këtë biznes. “Këtë kompani e kam funksionale që 20 vjet. Unë e kam pranuar detyrën më 27 mars të vitit 2011 dhe nuk kam mundur me deklarua pasurinë dhe gjykata më ka dënuar me 200 euro. Ndërsa pas deklarimit të pasurisë që e kam bërë paskam harruar për ta deklaruar”, thotë Krasniç. Krasniç në këtë kompani ka pasur qarkullim për shumë vite dhe vazhdon të ketë ende. Kompania e tij në vitin 2000 ka pasur 1 mijë e 273 euro qarkullim financiarë, në vitin 2001 ka pasur 4 mijë euro, në vitin 2003 ka pasur 4 mijë e 150 euro, në vitin 2004 ka pasur 5 mijë e 233 euro, në vitin 2006 ka pasur 12 mijë e 484 euro, në vitin 2007 ka pasur 20 mijë e 828 euro, në vitin 2008 ka pasur 18 mijë e 666 euro, në vitin 2009 ka pasur 33 mijë e 982 euro, në vitin 2010 ka pasur 26 mijë e 920 euro dhe në vitin 2011 ka pasur 15 mijë e 541 euro qarkullim financiar.

Ndërsa, Ilir Tolaj, ish-sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, nuk e ka deklaruar

kompaninë “I M C”, në të cilën është bashkëpronar me Gazmend Pruthin. Ai momentalisht është i arrestuar nën dyshimet për përfshirje në korrupsion.

Edhe disa kryetarë të komunave nuk i kanë deklaruar në AKK bizneset e tyre. Kryetari i Suharekës Blerim Kuçi nuk e ka deklaruar kompaninë “Universal Group”, të cilën e ka në bashkëpronësi me Blerim Graincën. Kryetari i komunës së Parteshit Nenad Svetkoviç nuk i ka deklaruar kompanitë “Mlp - Com” dhe “M & L - Com”. (Svetkovic në vitin 2007 në kompaninë e parë ka pasur qarkullim financiar prej 3 mijë e 125 euro, edhe në kompaninë e dytë po këtë vit ai ka pasur 3 mijë e 125 euro qarkullim financiar). Ndërsa kryetari i komunës së Lipjanit Shukri Buja nuk e ka deklaruar biznesin D.p.h “Bulevardi”. Edhe kryetari i komunës së Gjilanit Qemajl Mustafa, nuk e ka deklaruar kompaninë “Vision Oil “ Sh.p.k. në të cilën është bashkëpronar me Selatin Mehmetin, Begator Hilën dhe Alban Shehrin. Ndërsa, kryetari i komunës së Mitrovicës Avni Kastrati, nuk i ka deklaruar tri kompani në AKK: “Oil Trade”, “Eko-Kosva”, në të cilat është pronar dhe kompaninë “Amar”, e cila është e djalit të tij, ndërsa ai është person i autorizuar. (Kastrati në firmën “Oli Trade”, ka pasur qarkullime financiare për disa vite. Në vitin 2000 ka pasur 33 mijë e 372 euro, në vitin 2001 ka pasur 1 milion e 261 mijë e 300 euro, në vitin 2002 ka pasur 321 mijë e 360 euro qarkullim financiarë).

Arsyetimet e mos deklarimit të këtyre kompanive nga ana kryetarëve të komunave janë të paqëndrueshme. Ata thonë se nuk janë duke punuar me këto biznese, thënë se ato nuk kanë qarkullime financiare dhe se nuk e kanë ditur që janë të regjistruara ende në ARBK, pasi që kanë menduar se nëse bizneset nuk kanë qarkullime financiare dhe nuk kanë aktivitete biznesore ato shuhen vetvetiu!

Edhe disa drejtorë të prokurimeve nuk i kanë deklaruar në AKK bizneset e tyre, të cilat janë në emër të tyre dhe janë të regjistruara në ARBK, ashtu siç janë të gjitha bizneset e këtyre 25 zyrtarëve.

Afrim Maxhuni drejtor i prokurimit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë, nuk e ka deklaruar në AKK kompaninë “AA - HD”, e cila është në pronësi të tij. Feti Ibihi drejtor i prokurimit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk e ka deklaruar biznesin Kooperativa bujqësore “Malësia” në të cilën është bashkëpronarë. Edhe Adem Krasniqi, drejtor i prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë nuk e ka deklaruar kompaninë Ndërmarrja

Tregtare “Rrjeta”. Ndërsa, Arben Loshi drejtor i prokurimit në Ministrinë e Jashtme, nuk e ka deklaruar kompaninë “Beni - Keramikë”, në të cilën është pronar. Edhe këta zyrtarë tentojnë të japin arsyetimet e njëjta, se gjoja nuk kanë pasur aktivitete biznesore në vitet e fundit dhe se kanë menduar se nuk duhet që t’i deklarojnë në AKK këto biznese.

Edhe disa drejtorë dhe anëtarë të bordeve të kompanive publike nuk i kanë deklaruar bizneset në AKK. Gani Sylja drejtor i bordit në Postën dhe Telekomin e Kosovës, nuk e ka deklaruar kompaninë “Dreni”, në të cilën është bashkëpronar. Edhe Nuhi Ahmeti drejtor i bordit në Postën dhe Telekomin e Kosovës nuk e ka deklaruar në AKK kompaninë “Natyra”. Ndërsa, Fadil Ismajli, drejtor në KOSST nuk e ka deklaruar kompaninë “Arting”, në të cilën është bashkëpronar me Mehmet Ahmetajn dhe Misin Vocin. Flamur Keqa anëtar i Bordit KEK nuk e ka deklaruar kompaninë “IBF consulting training”. Këta zyrtarë thonë se bizneset e tyre janë pasive dhe nuk kanë ditur që duhet të deklarohen dhe se Ligji për Deklarimin e Pasurisë i obligon ata që pavarësisht aktivitetit biznesor, bizneset që janë të regjistruara në emër të tyre duhet të deklarohen.

Ndërsa Asllan Vitaku kryesues i bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, nuk e ka deklaruar kompaninë “Asllan & Sons”, në të cilën është pronar. Ai thotë se nuk e ka deklaruar këtë kompani, me arsyetimin se nuk e ka ditur se duhet të deklarohet. “Në këtë kompani djali është menaxher dhe nuk e di pse nuk është deklaruar. Kjo nuk ka punë shumë, bëjmë punë të vogël..”, ka thënë Vitaku. Ai përmes kësaj kompanie ka pasur qarkullime financiare për vite të tëra dhe vazhdon të ketë ende. Kompania e Vitakut “Asllan & Sons”, në vitin 2005 ka pasur 1 mijë e 757 euro, në vitin 2006 ka pasur 4 mijë e 142 euro, në vitin 2007 ka pasur 5 mijë e 393 euro, në vitin 2008 ka pasur 16 mijë e 365 euro, në vitin 2009 ka pasur 13 mijë e 650 euro, në vitin 2010 ka pasur 16 mijë e 610 euro dhe në vitin 2011 ka pasur qarkullim financiarë 3 mijë e 455 euro.

Edhe Hanefi Muharremi anëtar i bordit në ANP nuk e ka deklaruar biznesin “Zyra e Shërbimeve Eksperti Muharremi”. Ai nuk jep ndonjë arsye konkrete pse nuk e ka deklaruar këtë biznes. “Unë këtë biznes e kam prej vitit 2007 dhe nuk e di si është puna. Duhet me qenë aktive disa lëndë i bëjmë në gjykata. Por do ta shikoj se çka është puna”, ka thënë Muharremi. Aleksandër Janjiçeviq anëtar i



Njoftim për shkelësit e ligjit

Politikanë dhe zyrtarë të lartë të cilët janë të obliguar që ta deklarojnë pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsion (AKK) munden lirisht dhe pa asnjë brengë të fshehin biznese apo funksione që mund të kenë nëpër biznese të caktuara dhe nuk do të ndëshkohen. Kjo për shkak se AKK-ja, konsideron se mos-deklarimi i një pjese të pasurisë apo funksioneve që kanë nëpër biznese të caktuara zyrtarë të lartë publik, nuk përbën shkelje të Ligjit për Deklarim të Pasurisë. Në një hulumtim të publikuar në Nëntor të 2011, Organizata ÇOHU! dhe QKGH-ja patën gjetur se 7 deputetë nuk kanë deklaruar biznese të tyre apo funksione që kanë nëpër biznese të caktuara dhe këto të gjetura i pat denoncuar në AKK. Por, Agjencia pat vendosur që këta deputetë nuk e kanë thyer ligjin dhe rrjedhimisht edhe nuk pat filluar procedurën e kundërvajtjes. Ironikisht, AKK-ja pat konsideruar që zyrtarët e lartë publik, që me ligj janë të obliguar t’i bëjnë publike të gjitha posedimet që i kanë në emër të tyre si dhe funksionet që mund të kenë nëpër biznese, mund edhe mos t’i deklarojnë ato dhe ata mund të flenë rehat sepse AKK-ja nuk do të iniciojë procedurën e kundërvajtjes. Madje, Agjencia u ka lejuar të gjithë zyrtarëve të lartë publik që pasuritë në emër të tyre si dhe funksionet që i kanë mund t’i deklarojnë në AKK edhe pas afatit ligjor (31 mars i çdo viti kalendarik). Në bazë të këtij interpretimi që ka bërë AKK-ja, një zyrtar i lartë mund ta fshehtë një biznes ku potencialisht ka qarkullime/fitime dhe mund të marrë edhe tenderë publik dhe të shkaktojë edhe konflikte interesi dhe nëse zbulohet se nuk e ka deklaruar biznesin apo funksionin në atë biznes, nuk merr asnjë masë sanksionuese ndaj tij, por thjesht e dhëna e re i shtohet në regjistrin e deklarimit të pasurisë dhe zyrtari është në rregull me ligjin!... Vetë drejtori i AKK-së, Hasan Preteni gjatë prezantimit të raportit të Agjencisë për vitin 2011, ka deklaruar se nuk ka asnjë zyrtar të nivelit të lartë ndaj të cilëve është nisur ndonjë procedurë për mosdeklarim të plotë të pasurisë.

bordit në RTK-së nuk e ka deklaruar në AKK kompaninë P.P. “Inter - Commerce”, në të cilën është pronar. Edhe Rrahman Paçarizi ish-kryetar i bordit të RTK-së nuk e ka deklaruar biznesin e tij Instituti për Cilësi “ARAC “. Këta zyrtarë thonë se këto kompani i kanë joprofitabile dhe se nuk e kanë ditur që duhet të deklarohen edhe kur janë joprofitabile.

Aktiv apo pasiv?

Bizneset që janë të regjistruara në ARBK janë aktive dhe e kanë këtë status derisa pronarët të ndjekin procedurat përkatëse për shuarjen e bizneseve. Këtë e konfirmon edhe kryeshefi ekzekutiv i ARBK-së Gazmend Mejzini. “Një biznes konsiderohet aktiv derisa figuron si i regjistruar në databazën e ARBK-së. Nëse biznesi vendos të shuhet atëherë duhet të respektohen procedurat për shuarje, varësisht nga tipi i biznesit. Në ueb-faqen e ARBK-së mund gjenen procedurat dhe dokumentet e nevojshme për shuarje të bizneseve”, thotë Mejzini.

Praktikisht çdo biznes i regjistruar në ARBK mund të fillojë që të ketë qarkullime financiare në çdo moment apo edhe të konkurrojë në tenderë të ndryshëm për të fituar projekte. Gjithashtu, këto kompani nëse janë edhe fiktive, mund të konkurrojnë në tenderë të ndryshëm për të ndikuar tek “loja” me oferta. Kjo është njëra nga arsyet që Ligji për Deklarimin e Pasurisë obligon zyrtarët e lartë që t’i deklarojnë bizneset e tyre apo funksionet që kanë në ato biznese për të shmangur edhe konfliktin e mundshëm të interesit.

Dokumentet që janë të nevojshme për shuarje të biznesit individual ose ortakërisë së përgjithshme janë: Plotësimi i formularit përkatës, kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve), certifikata origjinale e biznesit, vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës, për shuarjen e biznesit. Ndërsa, dokumentet që janë të nevojshme për shuarjen e korporatave janë: Plotësimi i formularit përkatës, shpallja në gazetë ditore të likuidimit në tri Gjuhë ½ e faqes, vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për shuarje të biznesit, vërtetimi nga Gjykata Ekonomike, certifikata origjinale e biznesit, ID-të kopje të pronarit ose pasaportat kopje, nëse është pronari i huaj, vendimin për Likuidim i Korporatës, vendimin për emërimin e Likuidatorit, raporti mbi mjetet e kapitalit.

Pra vetëm përmes ndjekjes së këtyre proceduarve mund të shuhen bizneset dhe derisa nuk shuhet biznesi në ARBK, ai duhet të deklarohet, pavarësisht se a është profitabil apo joprofitabil.



MERRR JEP

BESA KALAJA

Së bashku me pushtetin, në Kosovë, vijnë edhe donatorët e partive politike. Ato gjatë zgjedhjeve pranojnë shuma të parave nga subjekte juridike dhe fizike në kundërshtim me Ligjin për Financimin e Partive Politike. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2010, partitë në pushtet, PDK dhe AKR kanë pranuar më së shumti donacione nga persona fizik dhe juridik për dallim nga partitë e tjera konkurruese në zgjedhje. Në raportin e auditorit të cilin e ka porositur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), rreth pasqyrave financiare të partive politike për vitin 2010, i cili është publikuar në qershor të vitit të kaluar, shihet se shkelësit më të mëdhenj të këtij ligji janë dy subjekte politike- Partia Demokratike e Kosovës dhe Alean-

ca Kosova e Re. Këto dy subjekte kanë numrin më të madh të donatorëve dhe si rrjedhojë edhe shkeljet janë të mëdha. Duke mos respektuar ligjin, donatorët, qoftë si persona fizik apo juridik kanë dhënë shuma më të mëdha parash se sa lejohet. Huluntimet e mëhershme të "Preportr", tregojnë se donatorët e partive në pushtet janë kryesisht kompanitë që marrin tenderë publik si kompensim për përkrahjen e tyre gjatë fushatave, gjë që përbën çenim serioz të konkurrueshmërisë në prokurimet publike. Në huluntimin e fundit "Preportr", ka gjetur se 43 subjekte të ndryshme, kryesisht kompani ndërtimore, që si biznese dhe persona fizik financuan Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), në dy fushatat e fundit elektorale kanë përfituar mbi 100 milionë euro nga tenderët publik.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e udhëhequr nga kryeministri Hashim Thaçi, është partia e cila ka pranuar më së shumti donacione si nga persona fizik po ashtu edhe nga juridik. Ky subjekt politik në raportin e auditorit ka dalë me më së shumti shkelje ligji dhe paregullësi të tjera, në të dhënat financiare që ia ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

PDK me shumë shkelje ligji

Ky huluntim është kryesisht i fokusuar në vlerën e marrë nga partitë politike në formë keshi, por kjo nuk është e vetmja formë që partitë pranojnë vlera nga sektori privat. Jo rrallë kompanitë ofrojnë përkrahje në formë shërbimesh, sidomos në marketing, të cilat pothuajse ngelen pa u monitoruar.

Subjektet politike në Kosovë kanë marrë donacione për fushatë më shumë se sa u lejohet me ligj. KQZ si organ mbikqyrës i partive, nuk i ka gjobitur ato për shkeljet që i kanë bërë, vetëm i ka detyruar që t'ia kthejnë kontributin e palejshëm kontributdhënësit. Në huluntimin e fundit "Preportr", ka gjetur se 43 subjekte të ndryshme, kryesisht kompani ndërtimore, që si biznese dhe persona fizik financuan Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), në dy fushatat e fundit elektorale kanë përfituar mbi 100 milionë euro nga tenderët publik.

"Magjistranja" nga Gjilani i ka dhënë PDK-së 16 mijë euro, që bjen në kundërshtim me Ligjin për financimin e partive politike, ku në nenin 1 dhe 1.2 thuhet se "Subjektet Politike lejohen të marrin kontribute nga: personat juridik në vlerë prej - jo më shumë se dhjetëmijë (10.000) euro për një (1) vit kalendarik".

Edhe kompania "Euro Trans", po nga Gjilani, ka dhënë më shumë mjete sesa lejohet me ligj. Kjo kompani i ka dhënë për PDK-në 10.500 euro.

Tejkalimin e limiteve të përcaktuara me ligj për financimin e partive politike përveç kompanive e kanë bërë edhe individë, kryesisht biznesmenë, që kanë ndonjë interes të lidhur me sektorin publik. Edhe në cilësinë e personave fizik që kanë financuar partitë duke tejkuluar limitet ligjore Nijazi Idrizi brenda një dite ka dhënë 7000 euro. Sipas raportit të auditimit të KQZ-së, për vitin 2010, edhe Florim Zuka, që është pronar i kompanisë "Tali", si subjekt fizik ka dhënë mjete për fushatën e PDK-së në vlerë prej 3000 eurosh.

Mjete më shumë se sa që lejohet kanë dhënë edhe: Gëzim Duraj 5000, Naser Kurti 5000, Shefki Xhakli 4500, Bejtush Mustafa 3500, Rexhep Ferizi 2.500, Musli Ramadani 6,497, Flurim Zeqiri 5.000, etj.

Këto donacione tejkalojnë limitin ligjor për donacionet e lejuara nga individë, gjegjësisht persona fizik, limit sipas ligjit duhet të jetë në vlerë prej jo më shumë se dy mijë (2,000) Euro për një (1) vit kalendarik - neni 1 dhe 1.1 i Ligjit për financimin e partive politike.

Te PDK auditori ka gjetur edhe shkelje të tjera. Në disa raste kur janë dhënë mjete nga një subjekt fizik që tejkalojnë shumën e 1,000 eurove nuk janë plotësuar të dhënat për numrin personal të donatorëve dhe ditën kur janë dhënë mjetet. Në raportin e auditimit të jashtëm thuhet se nuk janë plotësuar të dhënat sipas Rregullores 01/2008 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike.

Auditorit ka vërejtur se ky subjekt politik (PDK) nuk ka mbajtur kontabilitet të mirëfilltë, sipas standardeve të aplikueshme në Kosovë, prandaj të dhënat e prezantuar në formular nuk kanë besueshmëri, pasi që verifikimi i tyre në mungesë të dëshmime mbështetëse sipas auditorit ka qenë i pamundur.

Ironikisht shkelja e ligjit me mos-përmbushjen e kërkesave të standardeve të kontabilitetit, gjegjësisht mangësitë e dokumenteve financiare janë shndërruar në një formë mbrojtjeje për partitë shkelësit duke qenë se, sipas raportit të auditorit, është e pamundur të konstatohet nëse ekziston apo jo keqpërdorimi material.

"...në mungesë të dëshmime mbështetëse ne nuk ishim në gjendje... të verifikojmë nëse pasqyrat financiare të deklaruara nga subjekti politik janë të liruara nga keqpërdorimet materiale dhe nëse janë në harmoni me rregulloren 01/2008 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike dhe Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme 03-L/073", thuhet në raportin e auditimit.

► VAZHDON NGA FAQJA 7

Donacione nga jashtë vendit

Pas PDK-së partia që më së shumti ka marrë donacione është Aleanca për Kosovën e Re (AKR), e Behgjet Pacollit. Kjo parti sipas raportit të auditorit ka pranuar më shumë mjete nga një person brenda ditës se sa lejohet me ligj. Po ashtu shumë donacione këtij subjekti politik i kanë ardhur nga Zvicra. Përkrahja fisnore e AKR-së është një specifikë që dallon këtë parti nga tjerat. Kështu, individë me mbiemrin e kryetarit dominojnë listen e donatorëve, por duke pasur para sysh faktin se kryetari i AKR-së Behgjet Pacolli është një multimilionerë, ka mundësi që këta emra thjesht të jenë përdorur për të krijuar përshtypjen se financimi i kësaj partie nuk është thjesht njëburimor.

Habibe Bunjaku, Tahije Pacolli, i kanë dhënë nga 15,000 euro, Enver Pacolli 14,992 euro, Erika Campello 13,475 euro, Flamur Se-faj 20,000, Adnan Pacolli 19,965 euro, nga 19 mijë e 963 euro Armend Salihu e Luciana Gaitto dhe Daut Pacolli 15,200 euro.

Auditori nuk ka gjetur shkelje të kësaj natyre në dy parti tjera të mëdha në LDK dhe AAK, të cilat për këtë periudhë kohe kanë qenë jashtë pushtetit. Kjo në njëfarë forme konfirmon dyshimet se donacionet janë të lidhura ngusht me pushtetin e partive, të cilat sipas shumë hulumtimeve u kthejnë përkrahjen donatorëve duke përdorur kryesisht pushtetin mbi prokurimet publike.

Një skandal tjetër, është praktika e ndërhyrjes së kapitalit të huaj në financimin e partive politike, gjë që është e ndaluar në vendet demokratike duke qenë se mund të jetë cënim serioz i demokracisë. Partitë e vogla kryesisht ato të komuniteteve, kanë pranuar mjete nga jashtë shtetit që është në kundërshtim me Ligjin për financimin e partive politike Neni 11, pika 1.1 ku thuhet se “Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga: 1.1. institucionet qeveritare dhe joqeveritare të huaja, si dhe personat fizikë dhe juridik të huaj”

Subjekti politik Crnogorska Liberalna Stranka ka marrë donacion prej 3000 eurosh nga Mali i Zi. Mjete nga jashtë shtetit, ka marrë edhe subjekti politik “Levizja për Bashkim”, e cila ka pranuar mjete nga Shqipëria në vlerë prej 9,963 eurosh.

Pa sanksione për shkelësit e ligjit

Shkeljet që i shohim në këtë raportim nuk janë një dukuri e re në funksionimin e partive politike.

Ato kanë ekzistuar edhe në mandatet tjera, pra edhe në kohën kur në pushtet ishin parti tjera. Këto shkelje kanë sanksione tepër të ulëta, apo nuk sanksionohen fare, prandaj kjo është një dukuri që përsëritet vit pas viti.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve deri tani nuk ka shqiptuar asnjë gjobë ndaj subjekteve politike që në bazë të Raportit të auditorit e kanë shkelur ligjin. E vetmja masë e ndërmarrë nga KQZ ka qenë kërkesa nga partitë politike që këto donacione të dhëna në mënyrë joligjore thjesht t’iu kthejnë donatorëve, pa marrë kështu ndonjë pasojë për shkeljen e ligjit.

Fehmi Pireva, zyrtar i lartë ligjor në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, ka thënë se pas publikimit të raportit të auditimit, u kanë kërkuar partive, që t’ua kthejnë mjetet donatorëve në ato raste ku ka pasur tejkalime dhe në një afat prej 14 ditësh, sipas tij ato e kanë kryer këtë veprim.

“Këtë e kemi bërë mbështetur në Regullën nr. 01/2008 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike ku në nenin 17.7 thuhet se “Nëse partia e regjistruar politike pranon kontributin që nuk është i lejuar sipas kësaj Rregulle, kryetari i partisë ia kthen kontributin kontribuesit brenda katërmëdhjetë ditësh (14) nga koha e marrjes së informatës për kontributin e palejueshëm”, thotë ai.

Në rastet kur subjekti politik nuk ka qenë në gjendje t’ia kthej mjetet donatorit, kjo Rregullë e përcakton që mjetet të kthehen në Buxhetin e Kosovës.

Partia Demokratike e Kosovës e ka kryer deri tani këtë detyrim ndaj KQZ-së dhe në katër raste ku nuk janë gjetur donatorët, mjetet nga fondi i ndarë nga Kuvendi për këtë subjekt janë derdhur në Buxhetin e Kosovës.

Administratori i këtij subjekti politik, Halil Selimi edhe pse thotë që pjesa e mbledhjes së donacioneve për fushatë nuk është përgjegjësi e tyre, pasi në kohë fushate Shtabi i partisë i cakton njerëzit për t’i mbledhur mjetet, ata kanë bashkëpunuar me KQZ-në për kthimin e tyre.

“S’mund të them që në këto raste ka pasur shkelje të ligjit, mund të them që ato mjete janë marrë në mënyrë të parregullt. Tash janë rregulluar në bashkëpunim me KQZ-në”, ka thënë Selimi.

Ai ka treguar që partia nuk i ka gjetur 4 donatorë dhe mjetet që është dashur t’u kthehen, në vlerë prej 2,500 eurove janë derdhur në buxhetin e Kosovës.

“E vetmja mënyrë të ballafaqohesh me korrupsionin nuk është përmes persekutimit të individëve, sepse ato raste do të vazhdojnë, por është duke ndryshuar ekonominë.”

AMBASADORI CHRISTOPHER DELL, MAJ 2010

“Zyrtarët kosovarë dhe partitë politike janë aq shumë të futur në këtë fenomen sa që është e pamundur të ndryshohet diçka pa një vullnet të mirë të tyre ... ç’është edhe më keq ka raste kur gazetarët janë paguar për të shkruajtur artikuj....”

AMBASADORI CHRISTOPHER DELL, MARS 2012

Ambasadori amerikan Christopher Dell në fund të mandatit të tij është lëshuar në një sulm gjeneral ndaj akterëve të ndryshëm shoqëror kosovar duke i gjeneralizuar ata si të korrumpuar e të manipuluar. Sido që të jetë në kohën kur po bëheshin hulumtime mbi mënyrën e nënshkrimit të Kontratës për ndërtimin e Autostradës dhe dhënjes me koncesion të Aeroportit të Prishtinës, duke iu përgjigjur pyetjeve të Organizatës ÇOHU! mbi faktin se ofertat nuk ishin hapur publikisht ai kishte mbrojtur nënshkruesit e këtyre kontratave duke konsideruar „nostalgjik të luftës së ftohtë“ ata që hedhin dyshime mbi këto kontrata.

KEMAL ATA-DELL



Në PDK nuk kanë pranuar të tregojnë se cila është vlera e mjeteve që u është dashur t’i kthejnë. Jo zyrtarisht është thënë se janë diku më shumë se 50 mijë euro. Këto mjete janë kthyer nga Fondi për zhvillim dhe demokraci, që Kuvendi ia ka ndarë kësaj partie.

Partia tjetër që sipas raportit të auditorit del ta ketë shkelur ligjin duke pranuar donacione nga një donator brenda ditës më shumë se sa lejohet, nuk ka marrë asnjë ftesë nga KQZ për kthimin e mjeteve.

Hafize Pacolli përgjegjëse për financa në AKR, ka thënë se pasi kërkesa nuk u ka shkuar kjo lë të nënkuptohet se ky subjekt politik nuk e ka shkelur ligjin.

“Kjo mund të jetë edhe për faktin se të gjitha mjeteve në partinë tonë u dihet burimi. Të gjitha mjetet në këtë subjekt shkojnë përmes bankës dhe të gjitha faturat e bankës ne ua kemi dërguar KQZ-së dhe auditorit”, thotë ajo pa mundur të shpjegojë faktin se si ka ndodhur që auditori e ka evidentuar si shkelje ligji pranimin e donacioneve në vlera më të larta se 1,000 euro nga një donator brenda ditës nga ky subjekt politik.

Mungojnë zyrtarët e certifikuar financiar

Shkeljet e ligjit që subjektet politike më shumë i quajnë parregullësi, vijnë më shumë për mungesë të eksperiencës dhe njohjes së ligjit të atyre që i pranojnë donacionet.

Auditori ka vërejtur që subjektet nuk kanë zyrtarë financiar të certifikuar kurse një zyrtar i tillë i mungon edhe KQZ-së.

Mungesën e një zyrtari financiar e ka përmendur edhe drejtoresha e Zyrës për regjistrimin e partive politike, Miradije Mavriqi. Ajo ka lënë të nënkuptohet se shumë gjëra shkojnë keq pasi Zyra e ka një numër shumë të vogël të punëtorëve.

Edhe subjektet politike e kanë përmendur faktin që njerëzit në terren nuk i kanë fort të përgatitur.

Gjatë një tryeze që para pak ditësh e ka organizuar Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), që në fokus e ka pasur financimin e partive politike nga të gjithë pjesëmarrësit është përmendur mungesa e stafit të specializuar në KQZ, por edhe në parti politike.